

## **Indeksi Kosovar për Shoqëri Civile**

### **Pyetësor për organizata të shoqërisë civile**

Indeksi Kosovar për Shoqëri Civile është projekt hulumtues i KCSF-së ka për qëllim analizimin e gjendjes aktuale të shoqërisë civile dhe identifikimin e problemeve në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Ky pyetësor përmban pyetje rreth strukturës dhe funksionimit të organizatave të shoqërisë civile, përfshirë kornizën ligjore, fondet dhe burimet e financimit, kapacitetet për të zhvilluar dhe zbatuar projekte e programe, avokimin, pjesëmarrjen në vendim-marrje, ndikimin, etj.

Për të kursyer kohën tuaj dhe për përgjigje sa më të sakta, ju sugjerojmë që pyetësori të plotësohet ose nga Drejtori Ekzekutiv/Drejtoresha Ekzekutive ose nga pjesëtarë të stafit që kanë informata më të plota për organizatën dhe sektorin e shoqërisë civile në përgjithësi.

Emri i organizatës suaj dhe kontaktet do të evidentohen vetëm gjatë procesit të futjes së të dhënave në sistem (për arsye të validimit të saktësisë së të dhënave), ndërsa të gjitha të dhënat tjera do të jenë anonime dhe përdoren vetëm për analiza statistikore në kuadër të sektorit të shoqërisë civile në tërësi, dhe jo organizatave specifike.

Ju falënderojmë paraprakisht për kohën që po ia kushtoni plotësimin të këtij pyetësori!

## INFORMATA RRETH ORGANIZATËS

1. Emri i organizatës: \_\_\_\_\_
2. Lokacioni (qyteti/komuna): \_\_\_\_\_
3. Email adresa e organizatës: \_\_\_\_\_
4. Telefoni i organizatës: \_\_\_\_\_
5. Web-faqja e organizatës: \_\_\_\_\_
6. Faqja e Facebook-ut ose mediave tjera sociale: \_\_\_\_\_
7. Cila është fusha juaj kryesore e veprimtarisë? (Ju lutem merrni shënim të gjitha fushat e veprimtarisë së organizatës)

Fusha e veprimtarisë	Plotëso fushat e përmendura me ✓
1. Organizatë Studentore	
2. Rini	
3. Sport	
4. Transparencë dhe/apo llogaridhënie	
5. Përfshirje sociale	
6. Ndihmë sociale dhe psikologjike	
7. Dhënie të fondeve	
8. Shkencë	
9. Flora dhe fauna	
10. Zhvillim rural	
11. Integrime Europiane	
12. Hulumtime dhe analiza	
13. Mjedis	
14. Refugjatë/Riatdhesim	
15. Punësim	
16. Ndërtim i paqes	
17. Arsim	
18. Trajnime profesionale	
19. Zhvillim i shoqërisë civile/OJQ-ve	

20. Zhvillim ekonomik	
21. Të drejta të pakicave	
22. Demokratizim	
23. Sundimi i ligjit	
24. Mikrofinanca	
25. Kulturë	
26. Shoqatë e mediave	
27. Trashëgimi kulturore	
28. Asistencë ligjore	
29. Mbrojtje e konsumatorëve	
30. Teknologji Informative (TI)	
31. Pjesëmarrje qytetare	
32. Ndihmë humanitare	
33. Të drejta të fëmijëve	
34. Të drejta të njeriut	
35. Përkrahje biznesit	
36. Trashëgimi	
37. Ndihmë personave me nevoja të veçanta	
38. Përkujdesje shëndetësore	
39. Bujqësi	
40. Barazi gjinore/fuqizim i grave	
41. Avokim dhe lobim	
42. Tjetër, specifiko: _____	

- 8.** Si i përzgjedh organizata juaj çështjet specifike të cilat i trajton? (Rretho vetëm një përgjigje)
1. Në bazë të analizave të nevojave/brengave dhe kontakteve me grupet që i përfaqësojmë
  2. Në bazë të fondeve në dispozicion
- 9.** Cili nivel i qeverisjes është në fokusin kryesor të punës së organizatës suaj? (Rretho vetëm një përgjigje)
1. Fshati/qyteza specifike
  2. Komuna specifike
  3. Një numër i madh komunash
  4. Një institucion/disa institucione të pavarura
  5. Një ministri/departament i ministrisë
  6. Disa ministri/qeveria
  7. Kuvendi i Kosovës
- 10.** Kush janë përfituesit kryesorë të projekteve dhe aktiviteteve të organizatës suaj? (Rretho vetëm një përgjigje)
1. Kryesisht grupi i njëjtë i përfituesve

2. Grupet e përfituesve ndryshojnë varësisht nga projekti/aktiviteti
3. Nuk kemi ndonjë grup të caktuar përfituesish

## STRUKTURA E SHOQËRISË CIVILE

**11.** Në cilin vit është themeluar organizata juaj?

Në vitin: \_\_\_\_\_

**12.** A është regjistruar organizata juaj?

1. Po, në vitin: \_\_\_\_\_
2. Jo (Kalo në pyetjen 18)

**13.** (Për organizatat që janë regjistruar në mes të 1 Janar, 2014 deri më tani. Për organizatat që janë regjistruar më herët, kalo në pyetjen 14): Si do e kishit përshkruar procedurën e regjistrimit? (Pyetni për të gjitha pyetjet dhe rrethoni patjetetër një përgjigje, Po apo Jo):

Pyetjet	
1.Vendimi për t'u regjistruar ishte vullnetar	1. Po 2. Jo
2.Procedura e regjistrimit ka qenë e lehtë	1. Po 2. Jo
3. Procedura e regjistrimit nuk ka qenë e shtrenjtë	1. Po 2. Jo
4.Procedura e regjistrimit ka marrë më shumë kohë se që parashihet me ligj (60 ditë)	1. Po 2. Jo
5.Vendim-marrja ka qenë e ndikuar politikisht	1. Po 2. Jo
6.Vendim-marrja ka qenë arbitrare	1. Po 2. Jo
7. Procedurat administrative për regjistrim kanë qenë të tepërta	1. Po 2. Jo
8.Tjetër, specifiko: _____	1. Po 2. Jo

**14.** Cila është forma e regjistrimit të organizatës tuaj? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Shoqatë (organizatë e anëtarësisë)
2. Fondacion (organizatë pa anëtarësi)

**15. A ka organizata juaj Status për Përfitim Publik?**

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 17)

**16. Nëse po, procedura për ta marrë statusin ka qenë: (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Shumë e lehtë
2. E gjatë dhe e ndërlikuar

**17. Pse nuk ka organizata juaj Status për Përfitim Publik? (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Kemi aplikuar dhe jemi duke pritur përgjigjen
2. Nuk kualifikohemi për statusin e përfitimit publik
3. Nuk duam status të përfitimit publik sepse ky status nuk ofron asnjë përfitim në praktikë
88. Nuk e di

**18. Cili është organi më i lartë drejtues i organizatës tuaj? (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Kuvendi i anëtarëve (Kalo në pyetjen 20)
2. Bordi
3. Drejtori/drejtoresha e organizatës (Kalo në pyetjen 20)
4. Tjetër, specifik: \_\_\_\_\_ (Kalo në pyetjen 20)

**19. A është ndonjëri prej anëtarëve të Bordit i/e punësuar në organizatën tuaj? (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Jo, asnjëri/a
2. Po, Drejtori/Drejtoresha Ekzekutive është anëtar i/anëtare e Bordit
3. Po, disa anëtarë të Bordit janë të punësuar në organizatë
4. Po, i gjithë Bordi është i përbërë nga të punësuar në organizatë

**20. Kush i merr vendimet kryesore në organizatën tuaj? (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Kuvendi i Anëtarëve
2. Bordi
3. Drejtori/Drejtoresha Ekzekutiv/e
4. Stafi i organizatës
5. Tjetër, specifik: \_\_\_\_\_

**21. Sa herë është takuar organi më i lartë drejtues (Kuvendi i Anëtarëve apo Bordi) gjatë vitit 2015? (Rretho vetëm një përgjigje)**

1. Asnjëherë
2. Një herë
3. Dy herë

- 4. Më shumë se dy herë
- 88. Nuk aplikohet (Organizata nuk ka Kuvend të Anëtarëve apo Bord)

**MENAXHIMI, MENAXHIMI FINANCIAR, LLOGARIDHËNIA, TRANSPARENCA, KODI I MIRËSJELLJES**

**RAPORTIMI FINANCIAR (KONTABILITETI) DHE TAKSAT**

**22.** Cilat nga këto i paguani në baza të rregullta? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

- 1. Tatimin në të ardhura personale
- 2. Kontributin pensional të punëtorëve
- 3. Tatimin në qera/pronë
- 4. Tatimin në të ardhura të korporatave/Tatimin në fitim
- 5. Tatimin në vlerën e shtuar (TVSH)
- 6. Sigurimin shëndetësor të punëtorëve
- 7. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**23.** A raportoni rregullisht në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK)? (Rretho vetëm një përgjigje)

- 1. Po, raportojmë rregullisht
- 2. Jo, nuk raportojmë rregullisht
- 3. Jo, nuk raportojmë kurrë
- 99. Refuzoj të përgjigjem

**24.** Si i vlerësoni kërkesat e raportimit (përfshirë edhe atë financiar) nga autoritetet shtetërore (p.sh. Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, etj.)? (Përgjigjuni për secilën fushë me ✓)

	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Nuk pajtohem	Nuk e di
1. Të qarta dhe të lehta				
2. Të zbatueshme				
3. Proporcionale me madhësinë dhe llojin e organizatës sonë				
4. Tjetër, specifiko: _____				

**25.** A ka shkelur organizata juaj ndonjë dispozitë ligjore gjatë vitit 2015? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 27)
88. Nuk e di (Kalo në pyetjen 27)
99. Refuzoj të përgjigjem

**26.** Nëse po, a është sanksionuar organizata juaj për shkeljen e dispozitave ligjore? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 28)
99. Refuzoj të përgjigjem

**27.** Nëse po, si i vlerësoni këto sanksionime? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Sanksionimet kanë qenë të pajustificueshme dhe jo-proporcionale me llojin e shkeljes
2. Sanksionimet kanë qenë të justifikueshme por jo-proporcionale me llojin e shkeljes
3. Sanksionimet kanë qenë të justifikueshme dhe proporcionale me llojin e shkeljes

**28.** Sa auditime të jashtme financiare i keni pasur gjatë vitit 2015? (Shëno 0 nëse organizata nuk ka pasë asnjë auditim të jashtëm financiar)

\_\_\_\_\_ auditime

**29.** A i posedon organizata juaj dokumentet e mëposhtme? (Kërkoni nga respondent t'ju tregojë shembuj të dokumenteve në vijim dhe rrethoni përgjigjen 1, 2 apo 3, varësisht prej përgjigjes dhe se ju tregon dokumentin)

Lloji i dokumentit	
1.Kodin e mirësjelljes të personelit	1.Po, dhe tregon dokumentin 2.Po,por nuk tregon dokumentin 3.Jo, organizata nuk e ka këtë dokument
2.Rregulloren e punës	1.Po, dhe tregon dokumentin 2.Po,por nuk tregon dokumentin 3.Jo, organizata nuk e ka këtë dokument
3.Rregulloren financiare	1.Po, dhe tregon dokumentin 2.Po,por nuk tregon dokumentin 3.Jo, organizata nuk e ka këtë dokument
4.Rregulloren e Kuvendit të Anëtarëve/Bordit	1.Po, dhe tregon dokumentin 2.Po,por nuk tregon dokumentin 3.Jo, organizata nuk e ka këtë dokument

5.Kontrata të punës për stafin	1.Po, dhe tregon dokumentin 2.Po,por nuk tregon dokumentin 3.Jo, organizata nuk e ka këtë dokument
--------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------

## LEHTËSIRAT FINANCIARE

**30.** A keni përfituar nga lehtësirat tatimore (ju apo donatorë tuaj) gjatë vitit 2015? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 32)

**31.** Nëse po, nga çfarë lehtësira tatimore keni përfituar gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Lirim nga tatimi në të ardhura të korporatave/Tatimin në fitim
2. Lirim nga tatimi në qera/pronë
3. Lirim nga Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH)
4. Lirim nga taksat komunale
5. Lirim nga taksat doganore
6. Lehtësira tatimore për donatorët tuaj privat
7. Lehtësira tatimore për investimet pasive
8. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**32.** A i konsideroni procedurat për përfitimin e benefiteve tatimore të komplikuar? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Shumë të komplikuar
2. Deri diku të komplikuar
3. Të lehta
88. Nuk e di

**33.** Si i vlerësoni lehtësirat tatimore për donatorët, në qoftë se ka ndonjë? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Mjaftueshëm inkurajuese/nxitëse dhe të lehta për të përfituar nga to
2. Mjaftueshëm nxitëse por procedurat për të përfituar nga to janë shumë të komplikuar
3. Të pamjaftueshme dhe procedurat për të përfituar nga to janë shumë të komplikuar
4. Në Kosovë nuk ka stimuj te taksave për donatorët
5. Nuk kam njohuri për rregullat/ligjet e stimujve të taksave për donatorët



6. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET E BRENDSHME PËR TË ZBATUAR PROGRAMIN**

**STAFI**

34. Çfarë është struktura gjinore e organizatës tuaj? (Ju lutem shënoni numrin e meshkujve dhe femrave për të gjitha fushat e mëposhtme. Shënoni 0 për fushat ku nuk ka asnjë individ. Shënoni 99 për fushat që nuk aplikohen, p.sh. në qoftë se organizata nuk ka vullnetarë, Kuvend të Anëtarëve, etj.)

	Numri i meshkujve	Numri i femrave
1.Kuvendi i Anëtarëve/Bordi		
2. Pozitat udhëheqëse në organizatë p.sh. drejtorët/drejtoreshat, udhëheqësit/udhëheqëset e departamenteve/programave, etj. (Këtu nuk përfshihen anëtarët/udhëheqësit e Kuvendit/Bordit)		
3.Pjesa tjetër e stafit		
4.Anëtarët (nëse organizata ka anëtarë)		
5.Vullnetarët		

35. Si i vlerësoni kapacitetet e organizatës suaj për të mëposhtmet? (Përzgjidh vetëm një nivel për secilën fushë me shenjën ✓)

Niveli i kapaciteteve	I lartë	Mesatar	I ulët
1.Shkrim të projekt-propozimeve			
2.Gjetje të donatorëve/fondeve			
3.Zbatimi/menaxhim operativ të projekteve			
4.Menaxhim financiar të projekteve			

36. Në përgjithësi, kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në organizatën tuaj është: (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Jo më shumë se 1 vit
2. Mesatarisht 2 vite
3. 3-5 vite
4. Më shumë se 5 vite

**37.** Bazuar në fushën e veprimtarisë së organizatës, stafi juaj është: (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Shumë i përgatitur profesionalisht për fushën dhe punën përkatëse
2. Mesatarisht i përgatitur profesionalisht për fushën dhe punën përkatëse
3. I papërgatitur profesionalisht për fushën dhe punën përkatëse

**38.** Në përgjithësi, bazuar në nevojat dhe fushën e veprimtarisë, organizata juaj e ka: (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Shumë të lehtë të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht
2. Relativisht të lehtë të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht
3. Shumë të vështirë të gjejë dhe punësojë staf të përgatitur profesionalisht

**39.** Cilat janë 3 aftësitë dhe 3 mangësitë kryesore të stafit tuaj? (Plotësoni të gjitha fushat për të cilat përgjigjet respondentit. Shenjëzoni fushat boshe me vizë /).

1.1.Aftësia 1:		2.1.Mangësia 1:	
1.2.Aftësia 2:		2.2.Mangësia 2:	
1.3.Aftësia 3:		2.3.Mangësia 3:	

**40.** Cilat janë kriteret kryesore që i merrni parasysh kur punësoni staf të ri? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Kualifikimi arsimor për fushën përkatëse
2. Përvoja e punës në fushën përkatëse
3. Përvoja e punës në sektorin e shoqërisë civile
4. Referencat nga organizatat/partnerët e besueshëm
5. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**41.** A ka përfituar organizata juaj nga programet qeveritare për nxitjen e punësimit gjatë vitit 2015? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po
2. Jo, sepse nuk ka programe për nxitje të punësimit në organizata të shoqërisë civile
3. Jo, sepse nuk kemi punësuar punëtorë të rinj vitin e kaluar
4. Jo, nuk kemi njohuri mbi programet e punësimit të qeverisë

## VULLNETARËT

**42.** Si e vlerësoni kornizën ligjore dhe politike për punë vullnetare në Kosovë? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Stimuluese

2. Deri diku stimuluese
3. Aspak stimuluese
4. Nuk ka kornizë ligjore apo politike për angazhimin e vullnetarëve
88. Nuk e di

**43.** Si e vlerësoni dinamikën e punës vullnetare në shoqëri civile në përgjithësi gjatë vitit 2015?  
(Rretho vetëm një përgjigje)

1. Në rritje
2. Pa ndryshim/E njëjtë (Kalo në pyetjen 46)
3. Në rënie (Kalo në pyetjen 45)
4. Nuk e di

**44.** Sipas mendimit tuaj, çka ka ndikuar në rritjen e punës vullnetare gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Përfitimet jo-monetare për vullnetarë (p.sh. përvoja)
2. Mungesa e vendeve të punës me pagesë
3. Imazhi i mirë i shoqërisë civile
4. Ngritja e vetëdijes për punë vullnetare
5. Dëshira për t'i ndihmuar punës së suksesshme të institucioneve përgjegjëse për fusha të caktuara/për të ndryshuar situatën
6. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**45.** Sipas mendimit tuaj, çka ka ndikuar në rënien e punës vullnetare gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Mungesa e përfitimeve jo-monetare për vullnetarë, p.sh. përvojës së punës
2. Gjendja e vështirë ekonomike në Kosovë
3. Imazhi jo i mirë i shoqërisë civile
4. Mungesa e vetëdijesimit të popullsisë për punën vullnetare
5. Zhgënjimi nga puna e institucioneve përgjegjëse për fusha të caktuara
6. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**46.** A jeni në dijeni për ndonjë program shtetëror që mbështet angazhimin e vullnetarëve? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po
2. Jo ( Kalo në pyetjen 48)

**47.** Nëse po, cilat? (Shëno emrat e programeve të ndara me presje)

---

48. A keni angazhuar vullnetarë gjatë vitit 2015 në organizatën tuaj?
1. Po
  2. Jo (Kalo në pyetjen 50)
49. Nëse keni angazhuar vullnetarë gjatë vitit 2015, cila ka qenë forma e angazhimit? (Rretho vetëm një përgjigje)
1. Përmes kontratave me shkrim
  2. Përmes marrëveshjeve verbale
  3. Nuk janë angazhuar në formë zyrtare sepse nuk është e obligueshme me ligj
  4. Nuk janë angazhuar në asnjë formë zyrtare sepse nuk ka qenë e nevojshme sepse janë angazhuar për kohë shumë të shkurtër
50. A e promovon lënda e edukatës qytetare angazhimin qytetar? (Rretho vetëm një përgjigje)
1. Po, lënda e edukatës qytetare e promovon mjaftueshëm angazhimin qytetar
  2. Jo, lënda e edukatës qytetare nuk e promovon mjaftueshëm angazhimin qytetar
  3. Edukata qytetare nuk është pjesë e kurrikulës zyrtare
  88. Nuk e di

## RRJETËZIMI

51. Në sa rrjete, grupe ombrellë ose federata është anëtare organizata juaj? (Nëse organizata nuk është anëtarë askund – rrjete, grupe ombrellë apo federata – shëno 0 dhe kalo në pyetjen 53).  
\_\_\_\_\_ organizata/grupe ombrellë/federata
52. Sa herë jeni takuar ose keni shkëmbyer informata përmbajtësore për çështje të fushëveprimtarisë së rrjetit gjatë vitit 2015? (Shëno 0 për organizatat që nuk kanë mbajtur asnjë takim apo nuk kanë shkëmbyer informata përmbajtësore asnjëherë gjatë vitit 2015)  
\_\_\_\_\_ herë
53. Përafërsisht sa organizata **që veprojnë brenda Kosovës** në fushën tuaj apo të ngjashme me organizatën tuaj i njihni? (Shëno 0 nëse përgjigja është asnjë)  
\_\_\_\_\_ organizata
54. Gjatë 3 muajve të fundit, përafërsisht me sa organizata tjera **që veprojnë brenda Kosovës** në fushën tuaj keni pasur takime ose keni shkëmbyer informata (p.sh. dokumente, raporte, të dhëna)? (Shëno 0 nëse organizata nuk ka shkëmbyer informata me asnjë organizatë tjetër)  
\_\_\_\_\_ organizata

55. Përafërsisht sa organizata **që veprojnë jashtë Kosovës** në çështje të njëjta apo të ngjashme me organizatën tuaj i njihni? (Shëno 0 nëse përgjigja është asnjë)

\_\_\_\_\_ organizata

56. Gjatë 3 muajve të fundit, përafërsisht me sa organizata tjera **që veprojnë jashtë Kosovës** në fushën tuaj keni pasur takime ose keni shkëmbyer informata (p.sh. dokumente, raporte, të dhëna)? (Shëno 0 nëse organizata nuk ka shkëmbyer informata me asnjë organizatë tjetër)

\_\_\_\_\_ organizata

57. Në bazë të përvojës tuaj, regjistrimi dhe pjesëmarrja në rrjete vendore dhe ndërkombëtare/të huaja është:

57.1. Rrjetet vendore (Rretho vetëm një përgjigje)

1. E lehtë, pa kërkesa të shumta burokratike
2. Regjistrimi i një rrjeti është i vështirë, por pjesëmarrja e lehtë
3. Edhe regjistrimi edhe pjesëmarrja në rrjete është sfiduese, me kërkesa të shumta burokratike
4. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_
88. Nuk e di

57.2. Rrjetet ndërkombëtare

1. E lehtë, pa kërkesa të shumta burokratike
2. Regjistrimi i një rrjeti është i vështirë, por pjesëmarrja e lehtë
3. Edhe regjistrimi edhe pjesëmarrja në rrjete është sfiduese, me kërkesa të shumta burokratike
4. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_
88. Nuk e di

## KORNIZA BAZË LIGJORE PËR VEPRIMIN E OSHC-ve

## VEPRIMTARIA

58. Në përgjithësi, rregulloret dhe ligjet për shoqërinë civile në Kosovë janë... (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Plotësisht kufizuese
2. Kufizuese
3. Pjesërisht kufizuese/të favorshme

4. Të favorshme
5. Plotësisht të favorshme

**59.** Gjatë vitit 2015, a është ballafaquar organizata juaj me kufizim të lirisë së asociimit offline (shoqata, fondacione, nisma qytetare) dhe/apo online (forumet e Internetit, Skype, Facebook, etj.)?

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 61)

**60.** Nëse po, me çfarë lloj kufizimesh të lirisë së asociimit (online apo offline) jeni ballafaquar gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Mohim diskriminues/kufizim në lirinë e asociimit offline, p.sh. në baza gjinore, të racës, bindjeve fetare, etj.
2. Ngacmim i stafit, anëtarëve, vullnetarëve dhe personave tjerë të angazhuar në organizatën tonë
3. Mohim diskriminues/kufizim i aplikacioneve të Internetit, mbyllje e forumeve, grupeve të Facebook-ut, etj.
4. Monitorim i Skype-it, Facebook-ut dhe grupeve tjera për bisedim
5. Ngacmim i moderatorëve dhe/apo anëtarëve të grupeve online
6. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**61.** Gjatë vitit 2015, a është ballafaquar organizata juaj me ndonjë formë të presionit shtetëror apo ndërhyrje jologjore në çështjet e brendshme të organizatës?

1. Po
2. Jo (Kalo në pyetjen 63)

**62.** Nëse po, me çfarë forma të presionit shtetëror apo ndërhyrjesh ligjore në çështjet e brendshme të organizatës jeni ballafaquar gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Auditim i tepruar
2. Ndërhyrje në objektin(tet) e organizatës/inspektim i paparalajmëruar
3. Kufizim i paarsyeshëm i veprimtarisë së organizatës
4. Sulm jo-legjitim ndaj organizatës
5. Kontrolli i tepruar i rregullave të brendshme të organizatës
6. Aplikim diskriminues i masave administrative, përfshirë rregullat e shpërlarjes së parave
7. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

## LIRITË TJERA

- 63.** Gjatë vitit 2015, a keni marrë pjesë në ndonjë tubim, individualisht ose përmes organizatës suaj?
1. Po
  2. Jo (Kalo në pyetjen 65)
- 64.** Nëse po, rrethoni të gjitha pohimet me të cilat pajtoheni:
1. Nuk ka pasë kufizime të tepërta të vendit dhe kohës së tubimit
  2. Policët nuk kanë ushtruar forcë mbi pjesëmarrësit
  3. Nuk ka pasur kufizime në pjesëmarrjen e mediave në tubim
  4. Nuk pajtohem me asnjë nga këto pohime
  5. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_
- 65.** A keni organizuar/tentuar të organizoni ndonjë tubim (protestë, marsh, performancë në ambient të hapur) gjatë vitit 2015?
1. Po
  2. Jo (Kalo në pyetjen 67)
- 66.** Nëse po, a keni hasur në ndonjë nga pengesat e mëposhtme? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)
1. Organizim i komplikuar me procedura të tepërta administrative
  2. Kufizime të paarsyeshme të cilat nuk ju janë shpjeguar si duhet
  3. Ju si organizatorë kenë hasë në sanksionime të pajustificueshme dhe jeni ndaluar/arrestuar të organizoni tubimin
  4. Keni organizuar tubim spontan pa i njoftuar autoritetet shtetërore
  5. Nuk kemi hasur në pengesa
  6. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_
- 67.** A keni marrë pjesë në kundër-tubim (tubime të grupeve kundërshtuese në vendin e njëjtë në të njëjtën kohë)?
1. Po
  2. Jo (Kalo në pyetjen 69)
- 68.** Nëse po, rretho vetëm një nga përgjigjet e mëposhtme:
1. Tubimi është mbrojtur nga policia
  3. Tubimi nuk është mbrojtur nga policia
  4. Turma është shpartalluar nga policia
  5. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**69.** Sa shpesh keni përjetuar ju personalisht apo organizata juaj ndonjërin prej kufizimeve të paligjshme të lirisë së të shprehurit? (Përgjigjuni për shpeshhtësinë e secilit kufizim me shenjë ✓)

	Rregullisht	Nganjëherë	Njëherë	Asnjëherë
1.Presion për kritikën ndaj autoriteteve shtetërore				
2.Persekutim për fjalime kritikuese				
3.Kërcënime për shkak se keni pasur mendime të kundërta				
4.Blokimin e qasjes në mjetet/kanalet e komunikimit online				
5. Tjetër: _____				

**70.** A keni përjetuar ju personalisht apo organizata juaj ndonjërin prej kufizimeve të paligjshme të lirisë për të marrë dhe dhënë informata lirshëm? (Përgjigjuni për shpeshhtësinë e secilit kufizim me shenjë ✓)

	Rregullisht	Nganjëherë	Njëherë	Asnjëherë
1.Blokim të web faqeve, kanaleve të komunikimit dhe platformave tjera online				
2.Monitorim të paligjshëm të komunikimit nga autoritetet shtetërore				
3.Dënime sepse i përkisni ndonjë grupi të rrjeteve sociale				
5. Tjetër: _____				



**INFRASTRUKTURA PËRKRAHËSE (QENDRAT BURIMORE, TRAJNIMET NË DISPOZICION, EKSPERTIZA LIGJORE NË DISPOZICION)**

**71.** A mendoni se shoqëria civile në Kosovë ka në dispozicion.... (Përgjigju për disponueshmërinë e secilës mundësi të përkrahjes me shenjë ✓)

	Shumë pak	Mjaftueshëm	Shumë	Nuk e di
1.Organizata përkrahëse për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme?				
2.Trajnime relevante për menaxhim të organizatës?				
3.Trajnime specifike për fushat e veprimtarisë?				
4.Këshilla ligjore dhe praktike rreth çështjeve të funksionimit të organizatës?				
5.Këshilla ligjore dhe praktike rreth çështjeve specifike për fushat e veprimtarisë?				

**FONDET DHE BURIMET E FONDEVE**

**72.** Për çfarë periudhe kohore e bën organizata juaj zakonisht planifikimin e punës? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Për periudhë më të shkurtër se 6 muaj
2. Për periudhë në mes të 6 dhe 12 muaj
3. Për periudhë në mes të 13 dhe 24 muaj
4. Për periudhë në mes të 24 dhe 36 muaj
5. Për periudhë më të gjatë se 36 muaj

**73.** A keni arritur të siguronit mjaftueshëm fonde për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve gjatë vitit 2015?

1. Po
2. Jo

**74.** Sa projekte keni zbatuar gjatë vitit të fundit? (Shëno 0 në qoftë se organizata nuk ka zbatuar asnjë projekt gjatë vitit të fundit)  
 \_\_\_\_\_ projekte

**75.** Cila nga kategoritë e mëposhtme do të përshkruante më së miri të hyrat vjetore të organizatës suaj gjatë vitit 2015? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Më pak se 10,000 EUR në vit
2. 10,000 – 25,000 EUR në vit
3. 25,000 – 50,000EUR ne vit
4. 50,000 – 100,000 EUR në vit
5. 100,000 – 500,000 EUR në vit
6. 500,000 – 1,000,000 EUR në vit
7. 1,000,000 EUR – 2,000,0000 në vit
8. 2,000,0000 – 4,000,000 EUR në vit
9. Mbi 4,000,000EUR ne vit
99. Refuzoj të përgjigjem

**76.** Në krahasim me vitin e kaluar, të ardhurat dhe shpenzimet e organizatës suaj në vitin 2015....  
 (Rretho vetëm një përgjigje për të ardhurat dhe një për shpenzimet)

1.Të ardhurat në vitin 2015	2.Shpenzimet në vitin 2015
1.Janë rritur	1.Janë rritur
2.Nuk kanë ndryshuar	2.Nuk kanë ndryshuar
3.Janë zvogëluar	3.Janë zvogëluar
99.Nuk aplikohet (organizata është hapur në vitin 2015)	99.Nuk aplikohet (organizata është hapur në vitin 2015)

**77.** Çfarë lloji të përkrahjes financiare keni pranuar gjatë vitit 2015? (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Grante për projekte
2. Grante institucionale
3. Kontrata për shërbime
4. Asistencë teknike
5. Tjetër, specifiko: \_\_\_\_\_

**78.** Projektet që ju kanë financuar donatorët gjatë vitit 2015 i keni fituar: (Rretho të gjitha përgjigjet që aplikohen)

1. Përmes thirrjeve të hapura për aplikim
2. Jemi ftuar direkt nga donatori për të aplikuar

3. Kemi kërkuar direkt nga donatori të na financojë projekt/e të caktuar/a
4. Tjetër, specifikoni: \_\_\_\_\_

**79.** Në përgjithësi, gjatë vitit 2015 procedurat e aplikimit për fonde në raport me shumën e projektit i konsideroni: (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Të lehta
2. Mesatarisht të vështira
3. Të vështira

**80.** Gjatë vitit 2015, çfarë përqindje e burimeve financiare të organizatës suaj kanë ardhur prej burimeve në vijim (shënoni përqindjen e burimeve totale në kllapa)? (Ju lutem keni parasysh që shumata totale e burimeve të ndryshme financiare nuk duhet të kalojë 100%)

Burimi i fondeve	Përqindja
1.Grante nga institucionet qendrore shtetërore	____%
2.Grante nga institucionet lokale (komunat)	____%
3.Kontrata nëpërmjet prokurimit publik	____%
4.Donacione nga kompanitë private vendore	____%
5.Donatorët e huaj	____%
6.Donacionet individuale vendore	____%
7.Të ardhurat nga tarifat e anëtarësimit	____%
8.Të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve	____%
9.Investimet pasive (të vetë organizatës) <sup>1</sup>	____%
10.Fondet investive <sup>2</sup>	____%
11.Tjera, specifikoni: _____	____%
<b>Total</b>	<b>100%</b>

**81.** A ka marrë organizata juaj fonde të huaja gjatë vitit të fundit? (Rretho vetëm një përgjigje)

1. Po, pa procedura shtesë të obligimeve/aprovimit në krahasim me fondet vendore
2. Po, me më pak procedura të obligimeve/aprovimit në krahasim me fondet vendore
3. Po, mirëpo me procedura shtesë të obligimeve/aprovimit në krahasim me fondet vendore
4. Jo, nuk keni marrë fonde nga jashtë sepse procedurat shtesë të obligimeve/aprovimit kanë qenë të komplikuar
5. Jo, nuk keni marrë fonde të huaja
6. Tjetër, specifikoni: \_\_\_\_\_

